



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.881/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesuese, Burim Ademi dhe Afijete Sada Gillogjani anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Sherife Balaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli Prishtine, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.881/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Sherife Balaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosove, me seli në Prishtine.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Sherife Balaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosove, me seli në Prishtine, në të cilën kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 2018A/03D duke u bazuar ne votuesit e sigurt dhe te besueshëm i cili ka votuar me familjen e tij, kemi vërejtur qe nuk figurojn votat e tij ne FRK.
Ketu egziston dyshimi se kemi te bëjmë me keqpërdorim ose pakujdesi te procesit te numrimit te votave. Andaj duke u bazuar ne kompetencat e juaja dhe te drejtën time si kandidat, kërkoj nga ju te rinumërohet votat ne vendvotimin 2018A/03D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Sherife Balaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtine, ka parashtuar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 2018A/03D ne Prizren.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.881/2021 më datën 06.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Zyhdi Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.